



Pranuar më 06.01.2023
Zyfa e [illegible]
308 01-03/A

**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

Rruga e Shikronjave Nr. 1, 20000  
Prizren, Republika e Kosovës;  
Tel:+381 (0) 29- 232 140;  
Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**STRATEGJIA PËR VEPRIMTARI**  
**KËRKIMORE-SHKENCORE 2020**  
**– 2024 (i rishikuar)**

Prizren, Janar 2020



---

**STRATEGJIA PËR VEPRIMTARI KËRKIMORO-SHKENCORE**  
**2020 – 2024 (i rishikuar në vitin 2022)**

**Hartuesit:**

- |   |   |        |
|---|---|--------|
| 1. Prof. Ass. Dr. Shemsi MORINA                   | - | anëtar |
| 2. Prof. Ass. Dr. Rifat MORINA                    | - | anëtar |
| 3. Prof. Ass. Dr. Armend PODVORICA                | - | anëtar |
| 4. Prof. Asoc. Dr. Halil KUKAJ                    | - | anëtar |
| 5. Zt. Arianit BERSHIA (përfaqësues i studentëve) |   | anëtar |

Komisioni për rishikimin e Planit strategjik kërkimor shkencor 2020-2024 të krijuar me vendim të Senatit të UUHP *nr.prot 01-622 të datës 30.11.2022*

1. Prof.Ass.Dr.Zirije Hasani-Kryetare
2. Prof.Ass.Dr.Fatmir Mehmeti-Anëtar
3. Ass.Simeana Beshi
4. Prof.Ass.Dr. Nol Krasniqi—Anëtar
5. Valon Ibraimi—Anëtar

Ky dokument u miratua nga Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren në mbledhjen e mbajtur më: 11.02.2020.

Ky dokument i rishikuar u miratua nga Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren në mbledhjen e mbajtur më: 27.12.2022



---

## Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave .....	4
Fjala e Rektorit .....	5
Përmbledhje ekzekutive .....	6
1. Hyrje.....	9
2. Pëcaktimi i objektivave, masat dhe rezultatet.....	10
2.1 Objektivat zhvillimore.....	10
2.2 Masat dhe rezultatet e pritshme .....	10
3. Menaxhimi .....	17
4. Plani i veprimit dhe buxheti .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Menaxhimi .....	26



---

## Lista e shkurtesave

ASO	Zyra Austriake për Shkencë
BE	Bashkimi Evropian
BKUK	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
CITT	Qendra për Inovacione dhe Transfer të Teknologjisë
FP7	Programi Kornizë FP7
HEAL	Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë
IPA	Instrumenti për Asistencë të Para-anëtarësimit
KAIP	Partneriteti Kosovë-Austri në fushën e Arsimit të Lartë dhe të Shkencës
K-CIRT	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Shkencë dhe Teknologji
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
NjHSH	Njësia për Mbështetje të Hulumtimeve Shkencore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKSH	Plani Kombëtar i Shkencës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Republikës së Kosovës
RPSO	Zyra Mbështetëse për Hulumtim Shkencor
SCAAK	Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës
TIK	Teknologjia Informative dhe Komunikuese
USAID	Agjencia e SHBA-së, për Zhvillim Ndërkombëtar
WUS	Austria Shërbimi Universitar Botëror
ZEAL	Zona Evropiane e Arsimit të Lartë
ZZHA	Zyra për Zhvillim Akademik



## **Fjala e Rektorit**

Në emër të menaxhmentit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, dhe në emër të stafit akademik dhe studentëve më lejoni të përgëzoj grupin punues për hartimin e Strategjisë për Veprimtari Kërkimoro-Shkencore 2020 - 2024.

Kjo strategji, është rezultat i një procesi të gjatë, dhe i pjesëmarrjes së gjerë të ekspertëve nga fusha të ndryshme akademike dhe që mbështetet në Programin Kombëtar të Shkencës 2010-2015. Ky do të jetë dokumenti në të cilin do të mbështetet Universiteti i Prizrenit, për të ndërtuar dhe konsoliduar struktura dhe mekanizma që promovojnë kërkime shkencor të një niveli të krahasueshëm me Universitetet prestigjioze të vendeve të zhvilluara. Kjo strategji, adreson nevojën që të precizohen masat dhe instrumentet që Universiteti si institucion duhet ndërmarrë që kërkimi shkencor të jetë i lidhur ngushtë me arsimin universitar, me komunitetin biznesor, nevojat e tregut të punës dhe nevojat e shoqërisë në tërësi.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj strategjie Universiteti i Prizrenit synon të jetë ndër përfituesit kryesor të fondeve për kërkime shkencore të Republikës së Kosovës, qëllimi i tij është të rrisë pjesëmarrjen në kuadër të projekteve të financuara nga BE-ja, dhe ato ndërkombëtare. Nëpërmjet aktiviteteve për promovimin e kërkimeve shkencore, identifikimin e nevojave të komunitetit të biznesit përmes Bordeve Industriale si mekanizma relevant këshilldhënës, të ofrimit të shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe të institucioneve publike, të gjeneroj të ardhura shtesë nëpërmjet të cilave do të siguroj në vazhdimësi të aktiviteteve të saja kërkimoro-shkencore. Universiteti i Prizrenit do të shtoj numrin dhe cilësinë projekteve kërkimore, do të forcoj lidhjen e mësimdhënies me kërkimet shkencore, do të forcoj partneritetet ekzistuese, do të zgjeroj bashkëpunimin me institucionet kërkimore evropiane si dhe do të përmirësoj kapacitetet e menaxhimit të projekteve. Kjo strategji do të avancoj edhe marrëdhëniet e Universitetit të Prizrenit me agjencitë qeveritare, me institucionet tjera kërkimoro-shkencore, me bizneset dhe fondacionet që kanë të bëjnë me komercializimin e punës dhe pronësisë intelektuale.

Menaxhmenti i Universitetit të Prizrenit është shumë i përkushtuar për të zbatuar këtë Strategji, për të arritur rezultate të krahasueshme në nivel ndërkombëtar si dhe të kontribuj në zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.

Me  
Prof. Asoc. Dr. Ismet Tema, Rektor

respekt,



## **Përmbledhje ekzekutive.**

Hartimi i Startegjisë për veprimtari kërkimoro-shkencore 2020 – 2024 është rezultat i një procesi të pjesëmarrjes së gjerë të ekspertëve nga fushat e ndryshme akademike.

Pikënisje për hartimin e dokumentit strategjik kanë qenë prioritetet për veprimtari kërkimore e shkencore të artikuluar në Programin Kombëtar të Shkencës 2010-2015, dhe Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017 – 2021. Universiteti i Prizrenit i konsideron këto si prioritate të veta kërkimore dhe është i përkushtuar t'i ofroj përkrahje të veçantë njësive akademike, grupeve hulumtuese dhe individëve që bëjnë studime në këto fusha. Po ashtu, Universiteti është i vetëdijshëm se, në një të ardhme jo të largët, përqendrimi i kërkimeve që zhvillohen në këtë institucion, duhet të jetë në ato fusha ku kontributi shkencor është më domethënës, dhe që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Hapi i parë në procesin e zhvillimit të dokumentit strategjik ka qenë analiza e gjendjes, e cila është bërë në katër fusha:

1. Burimet njerëzore;
2. Infrastruktura;
3. Bashkëpunimi ndërkombëtar;
4. Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë.

Këto fusha korrespondojnë me ato të Programit Kombëtar të Shkencës. Janë analizuar faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në zhvillimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen. Analiza ka qenë pikënisje për identifikimin e strategjive të ndryshme për të shfrytëzuar të arriturat dhe për t'i tejkalluar dobësitë, por edhe për të krijuar ide se si mund të përfitohet nga mundësitë që ofron mjedisi dhe si mund të shmangen rreziqet që kërcënojnë. Për secilën nga katër fushat ku është analizuar gjendja është formuluar nga një objektiv zhvillimor. Objektivat përcaktojnë caqet e Universitetit për zhvillimin e veprimtarisë kërkimoro-shkencore në periudhën vijuese pesëvjeçare. Për secilin objektiv janë përcaktuar masat e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo masë janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit. Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e shkurtër e objektivave zhvillimore së bashku me masat e ndërlidhura:

**Objekivi 1:** Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimoro-shkencore në Universitetin e Prizrenit.

- 1.1. Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në njësitë akademike të Universitetit bazuar në sistemin e Bolonjës.



- 1.2. Krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit.
- 1.3. Nxitet qasja ndërdisiplinore në veprimtarinë kërkimoro-shkencore.
- 1.4. Zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimore e shkencore.
- 1.5. Nxitet përfshirja e kapaciteteve nga diaspora në veprimtarinë kërkimoro-shkencore.
- 1.6. Përcaktohen obligimet kontraktuale për kontribut në veprimtarinë kërkimoro-shkencore për personelin akademik.

**Objektivi 2: Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore e shkencore rreth ofrimit të shërbimeve.**

- 2.1. Zhvillohet baza e të dhënave për kapacitetet ekzistuese infrastrukturore në Universitet;
- 2.2. Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve në kuadër të Universitetit;
- 2.3. Lidhen marrëveshje për shfrytëzim të infrastrukturës kërkimore të institucioneve të tjera në vend dhe jashtë;
- 2.4. Themelohen, funksionalizohen laboratore, institute ose qendra të inovacionit dhe pajisen me infrastrukturë përkatëse;
- 2.5. Sigurohet qasja në biblioteka elektronike relevante.

**Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore e shkencore duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.**

- 3.1. Lidhen partneritete strategjike me institucione që kanë reputacion ndërkombëtar dhe me interes të bashkëpunimit me Universitetin;
- 3.2. Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve;
- 3.3. Ndahen fonde për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare;
- 3.4. Shpërndahet ose publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

**Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.**

- 4.1. Krijohet baza e të dhënave për projektet e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat;
- 4.2. Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për ofrimin e programeve profesionale me kohëzgjatje të ndryshme në përputhje me kërkesat e tregut;
- 4.3. Nxitet përfshirja e subjekteve ekonomike dhe shoqërore në hartimin dhe realizimin e programeve akademike të orientuara në kërkime dhe mësimin e bazuar në problem;
- 4.4. Angazhohen personeli akademik dhe studentet në sektorin publik dhe privat për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimoro-shkencore



## Objektivi 5: Nxitja e hulumtimit të përbashkët mësime-dhënës-student.

5.1. Plotësim ndryshimi i rregullores për kërkime shkencore ku përfshihet stimulimi i studentëve për publikime shkencore në revista dhe konferenca.

Zbatimi i Strategjisë dhe kërkesat që shtrohen para Universitetit bashkëkohor imponojnë nevojën për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e veprimtarisë kërkimoro-shkencore. Për këtë qëllim, do të fuqizohet Këshilli Shkencor për mbështetje të hulumtimeve shkencore. Po ashtu, do të formohet një Grup Këshillëdhënës për punë kërkimoro- shkencore dhe inovacion, i cili do të përcjell realizimin e Strategjisë dhe do të ofroj ekspertizën e vet për tejkalimin e problemeve. Strategjia përmban planin e zbatimit për periudhën 2020 - 2024, si dhe kornizën buxhetore që është përmbledhur në tabelën vijuese:

FUSHA	BUXHETI					Gjithsej
	2020	2021	2022	2023	2024	
Burimet njerëzore	25,000	25,000	25,000	30,000	30,000	135,000
Infrastruktura	37,000	10,000	10,000	10,000	10,000	77,000
Bashkëpunimi ndërkombëtar	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	125,000
Lidhja me ekonominë dhe shoqërinë	500	500	500	500	500	2,500
<b>Total:</b>	<b>87,500</b>	<b>60,500</b>	<b>60,500</b>	<b>65,500</b>	<b>65,500</b>	<b>339,500</b>

Fondet e nevojshme për implementimin e kësaj Strategjie paraqesin 12.4% të buxhetit vjetor të Universitetit të Prizrenit (rreth 2.65 mil. euro), pa i llogaritur të hyrat nga projektet nëpërmjet të cilave financohet komplet infrastruktura dhe pjesërisht shpenzimet e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe të hyrat vetanake nga veprimtaria akademike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e këtyre shpenzimeve janë bërë edhe deri tani, por jo në mënyrë të rregullt dhe të planifikuar.





## 1. Hyrje

Veprimtaria kërkimoro-shkencore e Universitetit të Prizrenit, edhe pse e inicuar më shumë nga individët, se sa të individëve të njësive akademike, dhe me mbështetjen e Programit të Komisionit Evropian Erasmus+ për nismën e themelimit të Qendrave të Inovacionit dhe Punësimit nëpër Universitete publike, edhe në Univesrsitetin e Prizrenit, u kujdesën që veprimtaria kërkimoro-shkencore të zhvillohet në mënyrë institucionale, duke i qartësuar objektivat strategjike të cilat synohen të arrihen dhe e kanë shtrirjen e aktiviteteve edhe nëpër njësi akademike si aktivitet mbi bazën e së cilës vlerësohet Universiteti. Gatishmëria e saj që nëpërmjet plotësimit të kërkesave të Standardeve Evropiane për ngjitjen e cilësisë në arsim, dhe përmes ofrimit të programeve studimore aplikative, me përzgjedhjen e tyre nga ana e Bordeve Industriale Këshilldhënëse, të konkurojnë në tregun e punës me kuadra të gatshëm me nivel të lart të kompetencës dhe shkathtësive të arritura në procesin arsimor në Universitet.

Strategjia e veprimtarisë kërkimoro-shkencore është e bazuar në Programin Kombëtar të Shkencës si dokument bazë që ofron një kornizë konceptuale për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore e shkencore në Kosovë, duke përcaktuar prioritetet kërkimore, objektivat zhvillimore, masat për arritjen e tyre, si dhe koston e zbatimit të programit, si zbatues të pjesëve kyçe të tij.

Qëllimi i këtij dokumenti është të shërbej si udhërrëfyes për mbështetjen dhe organizimin e punës kërkimoro-shkencore në Universitet.

Përmbushjen e këtij qëllimi do ta arrijnë nëpërmjet Rregullores për kërkime shkencore dhe Rregullores për Funkcionimin e Instituteve, Qendrave të Inovacionit dhe Punësimit, si dy dokumente kyçe për zbatimin praktik të Strategjisë për Veprimtari Kërkimoro-Shkencore.

Realisht, Universitetit të Prizrenit gjegjësisht njësive akademike iu ka munguar përvoja në fushën e kërkimeve shkencore. Në këtë kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, por një ndër ta është edhe mos interesimi i menaxhmentit të njësive akademike për krijimin dhe funksionalizimin e këtyre institucioneve të cilat do ta zhvillonin veprimtarinë kërkimoro-shkencore.



## 2. Përcaktimi i objektivave, masat dhe rezultatet e pritshme.

Gjatë analizave të gjendjes së veprimtarisë kërkimoro-shkencore në Universitetin e Prizrenit, u identifikuan katër fusha mbi bazën e rëndësisë dhe në përputhje me Programin Kombëtar të Shkencës. Fushat e identifikuara përbëjnë edhe objektivat zhvillimore për të cilat u ndërmorën masat për përcaktimin e aktiviteteve, u përcaktuan periudhat e zbatimit, u përcaktuan bartësit e aktiviteteve si dhe u parashikua kostoja e secilit aktivitet duke e formuar buxhetin total të zbatimit të Startegjisë për veprimtarinë kërkimoro-shkencore.

Fushat e identifikuara janë:

- a. Burimet njerëzore;
- b. Infrastruktura;
- c. Bashkëpunimi ndërkombëtar, dhe;
- d. Lidhja me komunitetin.

### 2.1 Objektivat zhvillimore

Nga katër fushat e identifikuara dhe të analizuar, janë formuar edhe objektivat zhvillimore të cilat njëherit janë edhe caqet e Universitetit për zhvillimin e veprimtarisë kërkimoro-shkencore në periudhën vijuese pesë vjeçare:

**Objektivi 1:** Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimoro-shkencore në Universitetin e Prizrenit.

**Objektivi 2:** Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore e shkencore për ofrimin e shërbimeve të komunitetit.

**Objektivi 3:** Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimoro-shkencore duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

**Objektivi 4:** Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

**Objektivi 5:** Nxitja e hulumtimit të përbashkët mësime-dhënës-student.



## 2.2 Masat dhe rezultatet e pritshme

**Objektivi 1:** Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimoro-shkencore në Universitetin e Prizrenit.

<b>Masat 1.1:</b>	<b>Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në njësitë akademike të Universitetit bazuar në Sistemin e Bolonjës</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Universiteti i Prizrenit do të inkurajoj njësitë akademike për zhvillimin e programeve të doktoratës të cilat do të zhvillohen në bashkëpunim me institucione të mirënjohura të arsimit të lartë dhe të shkencës nga vende të tjera. Universiteti i Prizrenit do të përkrah aplikimin për fonde që sigurojnë praninë e shtuar të komponentës kërkimoro-shkencore dhe zhvillimore në programet e doktoratës.</p> <p>Mënyra më e mirë për sigurimin e cilësisë së programeve të ndryshme në studimet e doktoratës është implementimi në përpikëri i Rregullores për Studimet e Doktoratës e cila do të përpilohet mbrenda vitit 2020-të.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>1.1.1. Në përputhje me Rregulloren, çdo vit Universiteti do të përkrah zhvillimin e së paku dy programeve të doktoratës në dicitelina të ndryshme.</p> <p>1.1.2. Çdo vit Universiteti do të përkrah regjistrimin e së paku 20 (njëzetë) studentëve të rinjë në studimet e doktoratës.</p>

<b>Masat 1.2:</b>	<b>Krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit.</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Universiteti i Prizrenit do të ofroj mbështetje për mobilitet afatshkurtër të hulumtuesve nga Universiteti në institucionet e vendeve të zhvilluara. Për të realizuar këtë aktivitet, Universiteti do të zhvilloj procedura që rrisin cilësinë dhe konkurrencën e veprimtarisë kërkimoro-shkencore si: zhvillimi i kriterëve për përzgjedhjen e përfituesve, informimi dhe shpallja publike me kohë lidhur me këtë mundësi, ndihmë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e qëndrimit afatshkurtër të personelit akademik jashtë vendit. Aktiviteti i tillë duhet të çoj në botime ose në krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm midis institucionit vendas dhe atij mikpritës.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>1.2.1. Çdo vit akademik Universiteti i Prizrenit mbështet financiarisht së paku 10 (dhjetë) mobilitete afatshkurtra për hulumtuesit më aktiv të Universitetit.</p> <p>1.2.2. Përgatitet dokumentacioni i nevojshëm dhe procedurat lidhur me qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit.</p>



<b>Masat 1.3:</b>	<b>Nxitet qasja interdisiplinare në veprimtarinë kërkimoro-shkencore</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Universiteti i Prizrenit do të favorizoj projektet me qasje interdisiplinare dhe me prioritet të cilat ngërthejnë në vete aktivitete kërkimore e shkencore për përmbushjen e nevojave të vendit. Me prioritet të veçantë do të jenë projektet kërkimore e shkencore të cilat realizohen përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.</p> <p>Me qëllim të fuqizimit të punës ekipore dhe shfrytëzimit racional të personelit akademik dhe infrastrukturës ekzistuese, Universiteti i Prizrenit do të nxisë komunikimin (veprimtarinë) kërkimoro-shkencore i cili promovon bashkëpunim brenda dhe në mes të njësive akademike të Universitetit të Prizrenit.</p> <p>Për këtë çështje, Universiteti së bashku me menaxhmentin e njësive akademike do të sigurojnë marrëveshje kontraktuale për personelin e angazhuar në projekte të tilla.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	1.3.1. Së paku 20% e fondeve të parapara për veprimtari kërkimoro-shkencore do të shpenzohen për projekte interdisiplinare.

<b>Masat 1.4:</b>	<b>Zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimoro-shkencore</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Universiteti i Prizrenit do zhvilloj kriteret për stimulimin e personelit të përfshirë në punë kërkimoro-shkencore. Këto kriteret duhet të përfshijnë: numrin dhe vlerën e projekteve shkencore të realizuara, numrin e publikimeve shkencore të publikuara në revistat shkencore të indeksuara në platformën Web of Science (WoS) dhe në platformën Scopus, lehtësime të veçanta kontraktuale për pjesëmarrje në programet kërkimore e shkencore (pas- doktorale, hulumtime të shkurtra në qendrat e përsosmërisë në të gjithë botën, etj.). Mbështetja do të synoj përfshirjen e hulumtuesve në fushat prioritare dhe interdisiplinare, në fushat ku ka mungesë të hulumtuesve në Universitetin e Prizrenit dhe përkrahjen e të rinjve që janë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve hulumtuese në Universitetin e Prizrenit.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	1.4.1. Miratimi i Rregullores për Kërkime Shkencore dhe masat për stimulim të personelit të përfshirë në punë kërkimoro-shkencore.



**Objektivi 2:** Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore e shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve për komunitetin.

<b>Masat 2.1:</b>	<b>Zhvillohet baza e të dhënave për kapacitetet ekzistuese infrastrukturore në Universitetin e Prizrenit</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Universiteti i Prizrenit aktualisht është në fazën përfundimtare të projektit “Creating Theory To Practice Centers For Innovation And Employment (T2P)”, qëllimi i të cilit është krijimi i Qendrës për Inovacion dhe Punësim, qendër e cila tani ma është funksionale dhe e vendosur në Fakultetin Ekonomik të Universitetit dhe zhvillon aktivitetet të cilat janë të parapara me këtë projekt, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm të studentëve si, dhe gjithë personelin akademik të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave Jetës dhe Mjedisit. Meqenëse në vjim është edhe projekti “Enhancing Research Culture in Higher Education in Kosovo – ResearchCul” i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve kërkimoro-shkencore, e i cili është vazhdimsi e projektit T2P-ë, atëher mund të konstatojmë se Universiteti pjesërisht e ka zgjidh problemin e infrastrukturës për sa i takon Qendrës për Inovacion si dhe mbështetjes praktike të zhvillimit të përvojave në proceset kërkimoro-shkencore, por edhe të pajisjeve të nevojshme për ta zhvilluar veprimtarinë kërkimoro-shkencore.</p> <p>Senati duhet ta themeloj një Komision për përcaktimin e kapaciteteve infrastrukturore në njësitë tjera akademike dhe konformë saj të ndërmerr veprime të nevojshme për hapjen e qendrave apo instituteve tjera kërkimoro-shkencore, por vetëm pas përfundimit të projektit “Enhancing Research Culture in Higher Education in Kosovo – ResearchCul” nëpërmjet të cilit do të zhvillohen trajnime për të përfituar njohuri të nevojshme dhe ngritjen e njohurive egzistuese në fushën e kërkimeve shkencore, me ç’rast stafi akademik dhe studentët do të jenë në gjendje të japin kontributin e tyre maksimal në fushën e kërkimeve shkencore.</p> <p>Universiteti i Prizrenit do të themeloj edhe fondin e veçantë për mirëmbajtje të infrastrukturës dhe blerje të pajisjeve kyçe dhe me përdorim të gjerë, si dhe për trajnimin e stafit për përdorimin e tyre.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>2.1.1. Raporti i Komisionit dhe informata për kapacitetet infrastrukturore të Universitetit të Prizrenit.</p> <p>2.1.2. Së paku 1% e buxhetit të Universitetit ndahet për mirëmbajtje të infrastrukturës dhe për pajisje të reja.</p> <p>2.1.3. Aftësohet stafi i Universitetit të Prizrenit për përdorimin e pajisjeve kyçe dhe me përdorim të gjerë.</p>



<b>Masat 2.2:</b>	<b>Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe paisjeve në kuadër të Universitetit të Prizrenit</b>
<b>Përshkrimi</b>	Duke u bazuar në raportin e Komisionit të Senatit dhe rekomandimet e tyre për kapacitetet infrastrukturore dhe gjendjen e saj, Këshilli Shkencor për kërkime shkencore do të hartoj Rregullore për përdorimin e përbashkët të laboratorëve dhe paisjeve të qendrave apo instituteve në kuadër të Universitetit.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	2.2.1. Miratimi i Rregullores përkatëse.

<b>Masat 2.3:</b>	<b>Sigurohet qasja në biblioteka elektronike relevante</b>
<b>Përshkrimi</b>	Do të ofrohet qasje në biblioteka elektronike, si dhe në resurse online të partnerëve strategjik.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	2.3.1. Qasjet në së paku dy platforma elektronike.





**Objektivi 3:** Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimoro-shkencore duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

<b>Masat 3.1:</b>	<b>Lidhen partneritete strategjike me institucione me reputacion ndërkombëtar që kanë interes për bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Universiteti i Prizrenit do të vazhdoj me zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe me lidhjen e marrëveshjeve të reja, i vetëdijshëm se çdo projekt i përbashkët kërkimor është në funksion të avancimit të veprimtarisë kërkimoro-shkencore në vend. Megjithatë, duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara për menaxhimin e bashkëpunimit dhe kërkesat që shtrohen me rastin e aplikimit për fonde, Universiteti duhet të përqendrohet në 2-3 institucione nga vendet evropiane dhe të rajonit me të cilat ka partneritet strategjik për realizimin e veprimtarisë kërkimoro-shkencore. Manifestimi më i dukshëm i partneriteteve të tilla është aplikimi i përbashkët për fonde kërkimore dhe realizimi i përbashkët i projekteve kërkimore.</p> <p>Mënyra më e mirë për t'i identifikuar këto institucione është realizimi i marrëveshjeve ekzistuese për të parë se cilat prej tyre janë më dobipurëse për Universitetin. Kjo është një ndër çështjet që duhet të diskutohet me Këshillin Kërkimor për Veprimtarinë Kërkimoro-Shkencore të Universitetit, duke nxjerrë rekomandimet përkatëse.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	3.1.1. Rekomandimet e Këshillit Shkencor për Veprimtarinë Kërkimoro-Shkencore të Universitetit për 2-3 partnerët strategjik të Universitetit.

<b>Masat 3.2:</b>	<b>Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve.</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Njësia për veprimtari kërkimoro-shkencore do të identifikoj një grup prej 12 (dymbëdhjetë) anëtarësh të personelit akademik të Universitetit që kanë përvojë në hartimin ose menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të karakterit akademik dhe janë të gatshëm që përvojën e tyre ta vënë në dispozicion të avancimit të veprimtarisë kërkimoro-shkencore në Universitet. Ky grup bërthamë do të trajnohet për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit në fushën e veprimtarisë kërkimoro-shkencore. Për trajnimin e mëtutjeshëm të anëtarëve të grupit bërthamë do të shfrytëzohen projektet ekzistuese të donatorëve. Anëtarët e grupit bërthamë do të jenë në dispozicion për të ofruar asistencë teknike për hartimin e projekteve në bazë të kërkesave të njësive akademike. Ata do të kontraktohen nga Universiteti për çdo rast të veçantë të ofrimit të shërbimeve të tilla dhe do të jenë përgjegjës për lehtësimin e procesit të planifikimit, si dhe për hartimin e aplikacioneve. Po ashtu, do t'i ndihmojnë njësitë akademike që t'i përmbushin kërkesat administrative që përcjellin çdo aplikim.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	3.2.1. Grupi bërthamë prej 12 (dymbëdhjet) persona. 3.2.2. Universiteti ofron asistencë teknike për planifikimin e të paktën 6 (gjashtë) projekteve kërkimore në vit. 3.2.3. Të paktën 2 (dy) persona nga çdo njësi akademike duhet të



	trajnohen për hartimin e projekteve kërkimore.
--	--

<b>Masat 3.3:</b>	<b>Ndahen fonde për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare</b>
<b>Përshkrimi</b>	Universiteti i Prizrenit do të themeloj një fond për bashkëfinancimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare me qëllim të nxitjes së veprimtarisë kërkimoro-shkencore në Universitet dhe në vend. Ideja është që fondi të krijohet nga të hyrat vetanake dhe buxhetore.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	3.3.1. Çdo vit Universiteti ndan së paku 1% të buxhetit të përgjithshëm për të përkrahur zbatimin e projekteve ndërkombëtare.

<b>Masat 3.4:</b>	<b>Shpërndahet apo publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.</b>
<b>Përshkrimi</b>	Njësia për veprimtari kërkimoro-shkencore do të shpërndaj informacionin për mundësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në zhvillimin e veprimtarisë kërkimoro-shkencore, artistike tek njësitë akademike, grupet hulumtuese dhe personeli akademik në Universitet. Hapi i parë do të jetë krijimi i një liste gjithëpërfshirëse të e_mailave ku do të dërgohen njoftimet dhe materialet e ndryshme. Po ashtu, informacioni do të publikohet edhe në faqen elektronike të Universitetit dhe do t'u komunikohet palëve të interesuara në takime të drejtpërdrejta. Në bashkëpunim me Zyrën për Informim, së paku katër herë në vit do të përgatitet një letër informative prej 2-4 faqe e cila do t'i kushtohet veprimtarisë kërkimoro-shkencore në Universitet dhe do të shpërndahet me postë elektronike.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	3.4.1. Informacioni relevant për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar shpërndahet të paktën një herë në tre muaj.

**Objekivi 4:** Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

<b>Masat 4.1:</b>	<b>Krijohet baza e të dhënave për projektet e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat.</b>
<b>Përshkrimi</b>	Universiteti do të krijoj një bazë të dhënash në të cilën do të prezantohen të gjitha marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit në mes të sektorit publik dhe privat të ekonomisë dhe Universitetit të Prizrenit. Kjo bazë e të dhënave duhet të jetë e detajuar në atë masë që, veç tjerash, të specifikoj edhe të gjithë emrat e kompanive dhe fushat e veprimtarisë, gjithashtu kjo bazë e të dhënave do të përditësohet vazhdimisht. Publikimi i saj do të bëhet në faqen elektronike të Universitetit në mënyrë që të jetë në dispozicion për të gjithë të interesuarit.
<b>Rezultatet e</b>	4.1.1. Zhvillimi dhe publikimi i bazës së të dhënave.





<b>prËtshme</b>	<b>4.1.2. Themelimi i Zyrës për Projekte.</b>
-----------------	---

<b>Masat 4.2:</b>	<b>Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për ofrimin e programeve profesionale me kohëzgjatje të ndryshme në përputhje me kërkesat e tregut.</b>
<b>Përshkrimi</b>	Do të zhvillohen mekanizma dhe instrumente për avancimin e bazës ligjore në Universitet më qëllim të qartësimit të modaliteteve të bashkëpunimit në mes të institucioneve nga ekonomia, shoqëria dhe Universiteti. Zhvillimi i këtyre mekanizmave përveç që do të institucionalizonte një qasje të këtillë, do t'i mundësoj Universitetit të Prizrenit që të ofroj programe të çertifikuara jo-akademike.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	4.2.1. Zhvillimi i bazës ligjore adekuate ku definohej qartazi të gjithë mekanizmat dhe instrumentet për ofrimin e programeve profesionale në përputhje me kërkesat e tregut.

<b>Masat 4.3:</b>	<b>Nxitet përfshirja e subjekteve ekonomike dhe shoqërore në hartimin dhe realizimin e programeve akademike të orientuara në kërkime.</b>
<b>Përshkrimi</b>	Qëllim i Universitetit është t'u ofroj studentëve programe akademike cilësore të standardeve të larta perëndimore. Për të arritur këtë, është e nevojshme angazhimi i gjitha njësive akademike të Universitetit të Prizrenit që gjatë zhvillimit të programeve të reja akademike (bachelor, master dhe doktoraturë) të inkuadrojnë domosdoshmërisht edhe palët e interesit nga fusha e ekonomisë dhe shoqërisë. Mënyra më e mirë për të bërë këtë është mundësimi i njësive akademike që të formojnë borde të veçanta industriale këshillëdhënëse të cilët do të përbëhen nga anëtarë që përfaqësojnë institucione nga ekonomia dhe shoqëria.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	4.3.1. Krijimi i bordeve industriale këshillëdhënëse në kuadër të njësive akademike të Universitetit.

<b>Masat 4.4:</b>	<b>Angazhohen personeli akademik dhe studentët në sektorin publik dhe privat për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimoro-shkencore.</b>
<b>Përshkrimi</b>	Në kuadër të marrëveshjeve që do të realizohen në mes të institucioneve nga sektori publik dhe privat, studentëve të nivelit pasdiplomik (master dhe doktoraturë) do t'u mundësohet që një pjesë të hulumtimeve të tyre ta kryejnë nëpër institucione nga sektori publik dhe privat.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	4.4.1 Institucionalizimi i internshipeve si pjesë e kurrikulës.



**Objektivi 5:** Nxitja e hulumtimit të përbashkët mësime-dhënësi-student.

<b>Masat 5.1:</b>	<b>Plotësim ndryshimi i rregullores për kërkime shkencore ku përfshihet stimulimi i studentëve për publikime shkencore në revista dhe konferenca.</b>
<b>Përshkrimi</b>	Duhet të bëhet ndryshimi i rregullores për Kërkime Shkencore ku të shtohet masa e re që stimulon me mbështetje financiare publikimet në revista dhe konferenca ku përfshihen studentët e UUHP.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Rritja e numrit të publikimeve të përbashkëta mësime-dhënësi-student



### 3. Menaxhimi

Universiteti i Prizrenit, është i përkushtuar për ndërtimin e një sistem efektiv të menaxhimit të aktiviteteve kërkimoro-shkencore në rend të parë duke vendosur standarde të cilësisë në mësimdhënie e në kërkime shkencore dhe duke i kushtuar rëndësi lidhjeve në mes të arsimit të lartë, kërkimeve shkencore, zhvillimit dhe mësimit gjatë gjithë jetës, ashtu siç është konfirmuar në Konkluzionet e Komunikatave të Bergenit (2005) e të Londrës (2007).

Ky synim i Universitetit del nga Komunikata e Leuvenit e vitit 2009-të, e ministrave të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL) ku thuhet: “Arsimi i Lartë i të gjitha niveleve duhet të bazohet në kërkimet shkencore, artistike dhe zhvillimore të sofistikuara duke kultivuar inovacionin dhe kreativitetin në shoqëri”.

Universiteti i Prizrenit, për ta realizuar këtë synim, duhet ta themeloj Njësinë për Mbështetje të Hulumtimeve Shkencore (NHSH), duke e fuqizuar rolin dhe dhe strukturën e saj si bartëse e aktiviteteve për promovimin e kërkimeve shkencore, përmbushjen e misionit dhe jetësimin e vizionit për kërkime shkencore në Universitet, organizimin dhe përgatitjen e Universitetit për planifikim të kërkimeve, hartimin e politikave kyçe që kanë të bëjnë me kërkimin, asistimin e hulumtuesve në përgatitjen e projekt-propozimeve, organizimin e punëtorive, si dhe inkurajimin dhe koordinimin e kërkimeve interdisciplinare. Njësia, duhet të ndihmoj dhe menaxhoj marrëdhëniet me agjencitë qeveritare të cilat sigurojnë se Universiteti i Prizrenit është duke përmbushur rolin e tij në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, të ndihmoj apo negocioj për marrëveshje të dimensioneve të mëdha me biznese dhe fondacione që kanë të bëjnë me komercializimin e punës dhe pronësisë intelektuale në kuadër të kërkimeve të sponsorizuara nga ekonomia. Meqë synohet që Universiteti i Prizrenit të jetë me afër kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë, është e nevojshëm që të ngriten edhe kapacitete tjera shtesë të cilat do të bartin këto aktivitete dhe do të mbanin kontaktet e vazhdueshme me këta sektorë. Në këtë kuadër, njësia duhet të bartë edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me inovacion, transfer të teknologjisë dhe ndërmarrësi. Një nga angazhimet më urgjente të kësaj njësie do të jetë përpilimi i bazës unike e të dhënave për gjendjen dhe aktivitetet përkatëse (do të ishte me ekonomike që të shfrytëzohen softuerë që mund të gjenden në shumicën e Universiteteve Evropiane dhe jo domosdoshmërisht duhet të zhvillohet nga fillimi).

Kjo njësi duhet të mbaj një koordinim të vazhdueshëm me strukturat tjera në kuadër të Rektoratit të Universitetit, Bordet Industriale Këshillëdhënëse, njësitë akademike si dhe strukturat tjera në nivel qeveritar si: K-CIRT-ja, CITT-ja në kuadër të MASHT-it, si dhe me agjenci të tjera shtetërore. Njësia duhet të kujdeset dhe të reflektoj edhe në procesin a hartimit ose rishikimit të statutit të Universitetit të Prizrenit.

Ky dokument strategjik duhet të zërthehet në plane operative, ku duhet të bëhet definimi i fushave prioritare për kërkime shkencore bazuar në sukseset dhe dobësitë e Universitetit, të ketë komunikim të ngushtë me njësitë e saj, në bazë të prioriteteve kërkimore nga Programi Kombëtar i Shkencës. Këto plane duhet të përmbajnë, mes tjerash, edhe treguesit



e arritjeve, procedurat për monitorimin e progresit, si dhe masat e duhura përfshirë edhe buxhetin e nevojshëm.

Por, duhet cekur se Universiteti akoma nuk e ka një autonomi të plotë menaxheriale dhe financiare e cila do të mundësonte realizimin e e Objektivave të Strategjisë për zhvillimin e shkencës në Universitet. Rrjedhimisht nuk do të ketë mundësi për t'i definuar qartazi të drejtat dhe obligimet e njësive dhe stafit akademik, për pjesëmarrje në projekte hulumtuese, zhvillimore dhe konsultative si dhe të drejtat pronësore e intelektuale të institucionit dhe individëve (stafit).

Me qëllim të ndërtimit të një sistemi për menaxhim efektiv të punës kërkimoro-shkencore, Universiteti i Prizrenit parasheh masat vijuese:

<b>Masa M1:</b>	<b>Fuqizohet Njësia për mbështetje të hulumtimeve shkencore (NjHSh) në Universitetin e Prizrenit</b>
<b>Përshkrimi</b>	Kjo njësi do të merret me analizën e kapaciteteve, procedurave dhe Rregulloreve të brendshme që kanë ndikim në aktivitetet kërkimoro-shkencore dhe është bartëse e aktiviteteve rreth përgatitjes së një plani të detajuar për kërkime shkencore përmes së cilit synohet edhe gjetja e fondeve për kërkime, planifikimi i shfrytëzimit të fondeve me efikasitet, dhe komercializimi i kapaciteteve infrastrukturore etj. Kjo njësi, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të Universitetit, do të kujdeset për zbatimin e vazhdueshëm të kriterëve për sigurimin e cilësisë në kërkime shkencore duke përfshirë stimulime për stafin e suksesshëm. Përveç kësaj, njësia do të mbaj kontakte të vazhdueshme me palët e interesit dhe do të asistoj njësitë dhe stafin e Universitetit në hartimin e projekteve që përfshijnë ekonominë, dhe shoqërinë. Po ashtu, do të mbaj kontaktet me të diplomuarit të cilët janë të angazhuar nëpër kompani me qëllim të promovimit të inovacionit, transferit të teknologjisë dhe ndërmarrësisë. Në perspektivë, ky funksion i njësisë për mbështetje të kërkimeve shkencore do t'i bartet qendrës për inovacion dhe punësim. Kjo njësi do të zhvilloj dhe mirëmbaj bazën e të dhënave për aktivitete kërkimoro-shkencore.
<b>Rezultatet e pritshme</b>	M1.1. Gjatë vitit 2020 të, përcaktohet numri i zyrtarëve të njësisë në 3 (tre), dhe të definohet roli i saj në kuadër të statutit të Universitetit dhe akteve përkatëse rregullative. M1.2. Njësia ofron asistencë teknike për mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me palët e interesit, dhe për planifikimin e të paktën 3(tre) projekteve në vit të cilat përfshijnë ekonominë dhe shoqërinë. M1.3. Hartohet dhe aprovohet Rregullorja për kërkime shkencore në nivel të Universitetit. M1.4. Zhvillohet sistemi i bazës së të dhënave, përfshirë: marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit në mes të sektorit publik dhe privat të ekonomisë dhe Universitetit; bashkëpunimin e Universitetit me ekonominë dhe shoqërinë, etj.



<b>Masa M2:</b>	<b>Krijohet Grupit Këshillëdhënës për punë kërkimoro-shkencore dhe inovacion në Universitetin e Prizrenit</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Statuti aktual përshkruan obligimet që ka Universiteti për të ofruar kushte adekuate për kërkime shkencore dhe se performanca individuale e stafit të Universitetit të Prizrenit në kërkime shkencore duhet të merret në konsideratë për vlerësimin profesional dhe zhvillim të karrierës. Edhe pse nuk i është kushtuar hapësirë e nevojshme, kjo qasje është moderne. Në këtë kuadër, do të themelohet Grupi Këshillëdhënës për punë kërkimoro-shkencore dhe inovacion cili do t'a këshilloi menaxhmentin e Universitetit për të ndërtuar dhe avancuar sistemin e menaxhimit dhe koordinimit të aktiviteteve kërkimoro-shkencore në Universitet, dhe për të vendosur mekanizmat për përgjegjësinë dhe llogaridhënien e strukturave drejtuese dhe stafit për veprimtari kërkimoro-shkencore. Në këtë kuadër, do të hartohen Rregullore për obligimet e stafit dhe menaxhmentit në kuadër të aktiviteteve kërkimore e shkencore. Veçmas do të definohej rregullat për pjesëmarrje në projekte, për gjenerimin dhe menaxhimin e mjeteve vetanake, dhe të krijohen kushte ligjore për zbatimin e tyre. Duke shfrytëzuar infrastrukturën e njesisë për mbështetje të kërkimeve shkencore, Grupi Këshillëdhënës do të bëjë një analizë fillestare (baseline study) lidhur me aktivitetet hulumtuese i cili do shfrytëzohet në proces të hartimit të planit të veprimit për punë kërkimore shkencore në Universitetin e Prizrenit. Ky grup, po ashtu, do të vlerësoj kërkesat dhe projekt-propozimet për mjete financiare nga fondi për kërkime shkencore i Universitetit dhe i rekomandon menaxhmentit për financimin e tyre. Ky grup emërohet nga Rektori dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga radhët e punëtorëve të dalluar të veprimtarisë kërkimoro-shkencore.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	M2.1. Themelimi dhe funksionalizimi i grupit një muaj pas aprovimit të Strategjisë.

<b>Masa M3:</b>	<b>Hartohen plane vjetore për veprimtarinë kërkimoro-shkencore të Universitetit.</b>
<b>Përshkrimi</b>	<p>Njësia për kërkime shkencore, në bashkëpunim me njësitet e Universitetit, do të përgatisë planin vjetor për aktivitete kërkimoro-shkencore duke identifikuar prioritetet dhe caqet në këtë fushë. Në këtë kuadër, edhe Grupi Këshillëdhënës do të jep rekomandimet e tij për masat e nevojshme që duhet ndërmarrë për të përkrahur dhe ngritur nivelin e aktiviteteve kërkimoro-shkencore të Universitetit.</p>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	M3.1. Plani vjetor i aprovuar.





#### 4. Plani i veprimit dhe buxheti

Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për të gjithë periudhën e zbatimit të Strategjisë, duke filluar nga viti kalendarik 2020, deri në përfundim të vitit kalendarik 2024. Kjo periudhë korrespondon me planifikimin buxhetor, duke siguruar një kontinuitet të veprimtarisë kërkimoro-shkencore. Është përcaktuar kostoja vetëm për ato masa që nuk mund të kryhen në kuadër të financimit të rregullt të veprimtarisë akademike të Universitetit. Si plani i veprimit, ashtu edhe buxheti janë të karakterit orientues dhe duhet të rishikohen para fillimit të çdo viti akademik, respektivisht fiskal.

**Objektivi 1:** Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimoro-shkencore në Universitet.

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					
				2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsej
<b>Masa 1.1: Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në njësitë akademike të UPz bazuar në Sistemin e Bolonjës</b>									
1.1.1.	Zhvillohen programet e doktoratës në përputhje me Rregulloren	tetor-mars (në çdo vit akademik)	Njësitë akademike						
1.1.2.	Programet aprovohen dhe dërgohen për akreditim	prill-maj (në çdo vit akademik)	Senati i Universitetit	10 000	10 000	10 000	10 000	10 000	50 000
1.1.3.	Shpallet konkursi për regjistrim në studime të doktoratës	shtator 2020 (pastaj çdo vit)	Senati i Universitetit						
Subtotali 1.1				10 000	10 000	10 000	10 000	10 000	50 000
<b>Masa 1.2: Krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit.</b>									
1.2.1.	Zhvillohen kriteret dhe procedurat për ndarjen e bursave	janar-mars 2021	NjHSh						
1.2.2.	Shpallet konkursi vjetor për bursa	janar dhe qershor (në çdo vit akademik)	Menaxhmenti						
1.3.3.	Ndahen bursat në përputhje me kriteret	mars dhe shtator (në çdo vit akademik)	Menaxhmenti	30 000	30 000	30 000	30 000	30 000	150 000
Subtotali 1.2				30 000	30 000	30 000	30 000	30 000	150 000



Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					
				2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsej
<b>Masa 1.3: Nxitet qasja interdisiplinare në veprimtarinë kërkimore shkencore</b>									
1.3.1.	Përcaktohet shuma e fondeve për përkrahje të kërkimeve interdisiplinar	qershor-tetor (çdo vit)	Mnaxhmenti						
1.3.2.	Caktohen fushat me prioritet për kërkime interdisiplinare	shtator-tetor (çdo vit)	Menaxhmenti Grupi Këshillëdhënës NJHSh						
Subtotali 1.3				-	-	-	-	-	-
<b>Masa 1.4: Zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimore shkencore</b>									
1.4.1.	Hartimi i rregullorës për stimulim të personelit	Tetor-dhjetor 2019	Komisioni i Këshillit Drejtues						
1.4.2.	Miratimi i Rregullorës	Shkurt 2020	Këshilli Drejtues						
Subtotali 1.4				-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI-1:</b>				<b>41 000</b>	<b>40 800</b>	<b>30 000</b>	<b>30 000</b>	<b>30 000</b>	<b>171 800</b>

**Objekti 2: Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore rreth ofrimit të shërbimeve për komunitetin.**

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					
				2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsej
<b>Masa 2.1: Zhvillohet baza e të dhënave për kapacitetet ekzistuese infrastrukturore në Universitetin e Prizrenit</b>									
2.1.1.	Hartohet metodologjia për inventarizim	maj-shtator 2020	NJHSh						
2.1.2.	Mbledhja të dhënave nga njësitë akademike për gjendjen e infrastrukturës kërkimore	shtator-tetor 2020	NJHSh						
2.1.3.	Zhvillohet baza e të dhënave dhe plotësohet me të dhënat e mbledhura	tetor-sentor 2020	NJHSh						
2.1.4.	Analiza e gjendjes së infrastrukturës dhe hartimi i rekomandimeve	dhjetor 2020	Grupi e Eksperteve	9 900					9900
Subtotali 2.1				9 900	-	-	-	-	9 900
<b>Masa 2.2: Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve në kuadër të Universitetit të Prizrenit</b>									
2.2.1.	Hartohet rregullorja për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve	janar-shkurt 2021							
2.2.2.	Miratohet rregullorja për përdorim të përbashkët të laboratorëve dhe pajisjeve	mars-prill 2021							
Subtotali 2.2				-	-	-	-	-	-
<b>Masa 2.3: Sigurohet qasja në biblioteka elektronike relevante</b>									
2.3.1.	Sigurohet qasje në biblioteka elektronike	2020 - 2024	Menaxhmenti			12 100	12 100	12 100	36 300
2.3.2.	Sigurohet qasja në resurse online të partnerëve strategjikë	në vazhdimësi	Menaxhmenti						
Subtotali 2.3				-	-	12 100	12 100	12 100	36 300
<b>TOTALI-2:</b>				<b>9 900</b>	<b>-</b>	<b>12 100</b>	<b>12 100</b>	<b>12 100</b>	<b>46 200</b>



**Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimoro-shkencore duke stimuluar përsosmërinë e kërkimeve.**

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					
				2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsej
<b>Masa 3.1: Lidhen partneritete strategjike me institucione me reputacion ndërkombëtar që kanë interes për bashkëpunim me Un. e Prizrenit</b>									
3.1.1.	Analiza e marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit	Janar-mars 2020	Grupi Këshillëdhënës NjHSh, ZMJ						
3.1.2.	Nsjerrja e rekomandimeve për lidhjen e partneriteteve strategjike	mj 2020	Grupi Këshillëdhënës						
3.1.3.	Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve me partnerë	maj-dhjetor 2020	Menaxhmenti						
<b>Subtotali 3.1</b>					-	-	-	-	-
<b>Masa 3.2: Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve.</b>									
3.2.1	Themelohet grupi bërthamë prej 12 anëtarë	Janar-mars 2020	Menaxhmenti						
3.2.2	Trajnimi për grupin bërthamë	2020-2024	NjHSh	10 000					10 000
3.2.3	Ofrimi i asistencës teknike për përgatitjen e projekteve	2020-2024	NjHSh						-
3.2.4	Trajnimi për personelin akademik për zhvillimin e projekteve	2020-2024	NjHSh						-
<b>Subtotali 3.2</b>				10 000	-	-	-	-	10 000
<b>Masa 3.3: Ndahen fondet për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare</b>									
3.3.1.	Merret vendimi për ndarjen e fondeve për bashkëfinancim	shtator-2020	Këshilli Drejtues						
3.3.2.	Ndahen fondet për të bashkëfinancuar zbatimin e projekteve ndërkombëtare	2020-2024	Këshilli Drejtues	20 000	10 000	10 000	10 000	10 000	60 000
<b>Subtotali 3.3</b>				20 000	10 000	10 000	10 000	10 000	60 000
<b>Masa 3.4: Shpërndahet/Publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.</b>									
3.4.1.	Shpërndahet/Publikohet informacioni për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar	Në vazhdimi	NjHSh						
<b>Subtotali 3.4</b>				-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI - 3 :</b>				30 000	10 000	10 000	10 000	10 000	70 000





**Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit shoqëro-ekonomik.**

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					Gjithsej
				2020	2021	2022	2023	2024	
<b>Masa 4.1: Krijohet baza e të dhënave për projektet e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat.</b>									
4.1.1.	Zhvillohet baza e të dhënave	mars-qershor or 2020	NjHSh						
4.1.2.	Mbledhjen informatat nga njësitë akademike dhe përfshihen në bazën e të dhënave	qershor-korrik 2020	NjHSh						
4.1.3.	Përditësimi i të dhënave në bazë	në vazhdimësi	NjHSh						
4.1.4.	Organizimi i takimeve me partnerëve	në vazhdimësi	NjHSh						
<b>Subtotali 4.1</b>					-	-	-	-	-
<b>Masa 4.2: Zhvillohen mekanizma dhe instrumente për ofrimin e programeve profesionale me kohëzgjatje të ndryshme në përputhje me kërkes</b>									
4.2.1	Hartohet Rregullorja për ofrimin e programeve profesionale	Qershor-Shtator 2020	ZZhA, NjHSh, Menaxhmenti		1 300				1 300
4.2.2	Aprovohet Rregullorja për ofrimin e programeve profesionale	Shtator-Tetor 2020	Keshilli Drejtues						
<b>Subtotali 4.2</b>				-	1 300	-	-	-	1 300
<b>Masa 4.3: Nxitet përfshirja e subjekteve ekonomike dhe shoqërore në hartimin dhe realizimin e programeve akademike të orientuara në kërkim</b>									
4.3.1.	Hartimi i një udhëzimi/rekomandimi për krijimin e bordeve të veçanta për fusha të caktuara në nivel të njëjësive akademike	Prill-Maj 2020	Bordi Këshillëdhënës NjHSh						
4.3.2.	Prezantimi i udhëzimit para dekanëve	Qershor 2020	Menaxhmenti						
<b>Subtotali 4.3</b>				-	-	-	-	-	-
<b>Masa 4.4: Angazhohen personeli akademik dhe studentet në sektorin publik dhe privat për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore</b>									
4.4.1.	Institucionalizim i i intershipeve në sektorin publik dhe privat në formë të një udhëzimi për procedurat e hartimit të kurrikulave	Maj-Shtator 2020	Menaxhmenti						
4.4.2	Identifikimi i partnerëve potencialë për kryerjen e hulumtimeve	Ne vazhdimësi	Njësitë akademike, ZZhA						
4.4.3	Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve për intershipe	Ne vazhdimësi	Menaxhmenti						
<b>Subtotali 4.4</b>				-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI - 4 :</b>				-	1 300	-	-	-	1 300



### Objektivi 5: Nxitja e hulumtimit të përbashkët mesimdhënës-student.

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					Gjithsej
				2020	2021	2022	2023	2024	
<b>Masa 5.1: Plotësim ndryshimi i rregullores për kërkime shkencore ku përfshihet stimulimi i studentëve për publikime shkencore në revista dhe konferenca.</b>									
5.1.	Publikohen punime të bashkëta	2023-24	Kësbilli Drejtues me propozim të menaxhmentit				5000	5000	
Subtotali 5.1					-	-	5000	5000	10000
<b>TOTALI-4:</b>					-	-	-	-	10000



## MENAXHIMI

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Bartësi	B U X H E T I					
				2020	2021	2022	2023	2024	Gjithsej
<b>Masa 1: Fuqizohet Njësia për mbështetje të hulumtimeve shkencore (NjHSh) në Universitetin e Prizrenit</b>									
M.1.1.	Marrja e vendimit për ristrukturimin e NjHSh	mars-prill 2020	Këshilli Drejtues me propozim të menaxhmentit						
M.1.2.	Konstituohet përbërja e re e NjHSh (3 persona me pagë mesatare 450 EUR)	Maj 2020	Menaxhmenti	3 600	5 400	5 400	5 400	5 400	25 200
Subtotali M.1				3 600	5 400	5 400	5 400	5 400	25 200
<b>Masa 2: Krijohet Grupi Këshillëdhënës për punë kërkimore shkencore dhe inovacion në Universitetin e Prizrenit</b>									
M.2.1	Themelohet Grupi Këshillëdhënës	janar-mars 2020	Rektori	3 000	3 000	3 000	3 000	3 000	15 000
Subtotali M.2				3 000	3 000	3 000	3 000	3 000	15 000
<b>Masa 3: Hartohen plane vjetore për veprimtarinë kërkimore shkencore në Universitetin e Prizrenit</b>									
M.3.1	Hartimi i planit vjetor	maj-shtator (çdo vit)	Menaxhmenti me ndihmën						
M.3.2	Aprovimi i planit vjetor	tetor (çdo vit)	Këshilli Drejtues						
Subtotali M.3				-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI - M:</b>				<b>6 600</b>	<b>8 400</b>	<b>8 400</b>	<b>8 400</b>	<b>8 400</b>	<b>40 200</b>